



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

2011-
2012

Tetovë, Maqedoni
Nëntor 2012

Përmbajtja

- 1.0 Hyrje
- 2.0 Të arriturat
- 3.0 Struktura: fakultet dhe qendrat
 - 3.1 Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë
 - 3.2 Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore
 - 3.3 Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit
 - 3.4 Fakulteti juridik
 - 3.5 Fakulteti administrimit publik dhe shkencave politike
 - 3.6 Qendra e gjuhëve
 - 3.7 Qendra për eNxënien (*The eLearning Centre*)
 - 3.8 Instituti i mjedisit dhe shëndetit
- 4.0 Sigurimi i cilësisë
- 5.0 Mësimdhënia dhe nxënia
 - 5.1 Programet dhe statusi
 - 5.2 Regjistrimi i studentëve
 - 5.3 Shkalla e kalueshmërisë së studentëve
 - 5.4 Shkalla e diplomimit e
 - 5.5 Vlerësimi i stafit akademik nga studentët
 - 5.6 Qendra e karrierës
 - 5.7 Asociacioni i alumni-it
- 6.0 Huluntimi
 - 6.1 Marrëdhëniet ndërkombëtare
- 7.0 Ndërrmarësia dhe zhvillimi
- 8.0 Financimi
- 9.0 Mjedisi në kampus dhe shërbimet
 - 9.1 Shërbimi studentor
 - 9.2 Ngrehinat dhe kapacitet teknike
 - 9.3 Qendra e UEJL-së në Shkup
 - 9.4 Burimet njerëzore
 - 9.5 Sistemet administrative
 - 9.6 Shërbimet e bibliotekës
 - 9.7 Unioni i studentëve
 - 9.8 Sport dhe rekreacion
- 10.0 Përfundimi

1.0 Hyrje

Raporti vjetor i Universitetit është për periudhën nga 1 shtatori 2011 deri 31 gusht 2012. Gjatë kësaj periudhe kohore Universiteti shënoi përvjetorin e dhjetë me festime, publikime, ceremoni, dhe reflektime. Në nëntor të vitit 2011 Universitetit iu nda Urdhri i Meritës për Maqedoni, i cili iu dha në një ceremoni zyrtare rektorit të universitetit z. Zamir Dika nga presidenti i Republikës së Maqedonisë, z. Gjorge Ivanov.

Sa i përket rangimit të universiteteve në Republikën e Maqedonisë — të kryer nga vlerësuesit e jashtëm Universiteti Shanghai Jiao Tong—Universiteti i Evropës Juglindore u radhit i dyti në nivel shtetëror, pas Universitetit Shtetëror “Shën Kiril dhe Metodi” nga Shkupi.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport i vetë-vlerësimit, Universiteti ndërmori një rishikim të gjerë të kurrikulave, hap ky i cili bë në pajtim me procedurat përkatëse shtetërore të akreditimit. Kjo ka bërë që Universiteti i Evropës Juglindore tani ofron programe studimore, me fokus të veçantë në punësimin e të diplomuarve me shkathtësi të veçanta për profesionet e tyre të zgjedhura

Universiteti vazhdon të ofrojë programe studimore deridiplomike dhe pasdiplomike në dy qendrat kryesore: kampusi kryesor në Tetovë dhe Qendra e UEJL-së Shkup. Kjo strukturë në dy lokacione ndihmon në ofrimin e shërbimeve për student të ndryshim të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në Universitetin e Evropës Juglindore dhe kjo e bën që UEJL të jetë konkurrent në mesin ofertuesve në rritje të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

Universiteti është duke vazhduar me angazhimin e tij për ndërkombëtarizimin. Numri i lëndëve që ofrohen në gjuhën angleze është në rritje, mirëpo Universiteti synon të rrisë më tej këtë segment. Stafi ndërkombëtar jep një kontribut të çmuar në larminë e programeve akademike UEJL-së, dhe për këtë sjellin ekspertizën e tyre akademike në Tetovë nga Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Irlanda, Shqipëria, dhe vendet e tjera. Studentët nga i gjithë rajoni kontribuojnë gjithashtu në cilësinë e jetës në UEJL. Ata, pra fqinjët rajonalë, si dhe nga komunitetet nga diaspora e largët jashtë vendit, sjellin me vete qasjet e ndryshme. UEJL shënon rritje të numrit të anëtarëve të stafit lokal të cilët kanë mbaruar studimet e magjistraturës dhe të doktoratës jashtë vendit dhe që janë kthyer për të sjellë ekspertizën e tyre.

Kriza e vazhdueshme ekonomike në botë, e kombinuar me hapjen e institucioneve të shumta konkurruese, nënkupton rënie në numrin e studentëve në studimet universitare dhe pasuniversitare në UEJL.

2.0 Arritjet

Sipas rangimit të realizuar nga Universiteti Shanghai Jiao Tong për institucionet e arsimit të lartë, UEJL u radhit në vendin e dytë në nivel shtetëror, që paraqet një arritje të rëndësishme për ne dhe reflekton shumë në konsistencën e përgjithshme të cilësisë së përsosmërisë akademike, hulumtuese, menaxhimit të integruar dhe mekanizmave të mirëvëzhguara për sigurimin e cilësisë.

Universiteti i Evropës Juglindore gjithashtu u nderua edhe për udhëheqjen rajonale në akademi, kur Presidenti i Republikës së Maqedonisë i prezantoi Universitetit Urdhrin e Meritës për Maqedoninë. Ky çmim, zakonisht është i rezervuar vetëm për institucionet me përvojë më të madhe dhe kjo ishte hera e parë që një institucion i Arsimit të Lartë ka marrë këtë çmimin pas vetëm dhjetë vjet ekzistence e veprimtarie.

Universiteti u nderua kur Kryeministri i Shqipërisë, zoti Sali Berisha, personalisht ka pranuar Çmimin për Leadership – që iu nda atij nga Instituti për demokraci dhe zhvillim në një ceremoni zyrtare në kampusin në Tetovë.

Universiteti i Evropës Juglindore ndërmori një rishikim të gjerë dhe riakreditim të kurrikulave. Ky hap u ndërmor për të siguruar mësimdhënie më të forta, profesionalisht më të fokusuar dhe kështu të sigurojë shkakësi të konsiderueshme për punësim dhe njohuri të praktike për të diplomuarit. Disa programe krejtësisht të reja janë krijuar gjithashtu dhe janë akredituar, si bie fjala Komunikimi ndërkombëtar, një program pa konkurrencë në tregun rajonal.

Universiteti ka ndërtuar edhe ndërtesën e parë eko-miqësore në një kampus universitar në Maqedoni, me kërkesa për energji të qëndrueshme dhe ndikim minimal mjedisor. UEJL ka vazhduar të ndjekë politika të dobishme për mjedisin, si për shembull koshat e riciklimit të letrës në të gjitha ndërtesat akademike dhe administrative dhe postimin e "Kodit të mjedisit" të UEJL-së në të gjitha klasat dhe zyrat e Universitetit. Kodi inkurajon sjellje të ndërgjegjshme për mjedisin, siç janë reduktimi i shtypjes së materialeve në letër, fikja e dritave dhe e kompjuterëve, kur nuk janë në përdorim dhe inkurajon ripërdorimin/riciklimin/uljen e burimeve.

UEJL ka vazhduar bashkëpunimin shumë të suksesshëm me Shkollën e Biznesit Kelley, nga Universiteti i Indianës, ku gjatë vitit 2012 kanë ardhur rreth 70 studentë nga Luknou nga India, për të studiuar në Tetovë. Këta studentë nga Instituti mjaft konkurrues indian i menaxhimit kanë qëndruar për nëntë ditë në kampusin tonë, ku kanë ndjekur leksione të ofruara nga profesorët vizitues nga Universiteti i Indianës.

UEJL ka pasur nderin që këtë vit presidentin e Universitetit të Indianës, Prof Michael McRobbie, për vitin 2011 ta shpallë Doktor Honoris Causa. Prof McRobbie dhe Universiteti që ai drejton, kanë qenë prej kohësh mbështetës dhe miq të Universitetit tonë dhe titulli që iu nda atij Honoris Causa ishte i merituar për interesimin e tij personal në UEJL si dhe në mbështetjen e tij për marrëdhëniet kolegjiale në arsimit e lartë. Kjo dhënia e titullit dhe pranimi i ndrit nga ana e tij, kanë për qëllim thellimin e marrëdhënieve mes dy universiteteve tona.

Si pjesë e një angazhimi të vazhdueshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në qershor të vitit 2012 Universiteti organizoi një konferencë kombëtare për sigurimin e cilësinë në mësimdhënie dhe nxënie, ku u paraqiten punime dhe prezantime nga stafi i UEJL-së dhe institucioneve të tjera të shumta të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë. Studentët nga UEJL dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë kanë prezantuar posterë gjatë sesioneve të hapura, duke e çuar përfshirjen e studentëve në konferencë. UEJL gjithashtu vazhdon me procesin e vëzhgimit të mësimdhënies, anketimin nga studentët dhe vlerësimi i stafit në fund të vitit. Këto procese ndihmojnë UEJL të jetë në përputhje me procedurat bashkëkohore për sigurimin e cilësisë që aplikohen në Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për më tepër, Universiteti vazhdoi traditën e trajnimit të rregullt duke organizuar një sesion treditör në Krushevë në fund të gushtit, i cili u përqendrua (në mesin e temave të tjera) në përafrimin e metodologjive të vlerësimit me rezultatet e pritura nga të mësuarit. Kjo ka shërbyer edhe për forcimin e komunitetit të universitetit, duke siguruar mundësi për veprimtari shoqërore dhe ndërveprim miqësor.

Universiteti vazhdon të ketë fokus shëndetin, fituesin dhe zgjedhjet e përgjegjshme të jetesës. Prandaj, për të promovuar sportin dhe mirëqenien fizike dhe për të përkujtuar Lojërat olimpike verore në Londër - Universiteti organizoi 'Ditën olimpike' në prill 2012. Studentët dhe stafi morën pjesë në një shumëllojshmëri të gjerë të aktiviteteve sportive, duke përfshirë tërheqje me litar, gara me thes, sprint, çiklizëm dhe kriket. Fituesve të garave iu ndanë çmime konkurruese nga zëvendësambasadori britanik. U organizuan disa ngjarje për grumbullimin e fondeve dhe një donator anonim ka dyfishuar fondet e grumbulluara dhe këto fonde u ndanë për bamirësi.

Vlen të theksohet se UEJL është krenar që ish-prorektori për ndërmarrësi dhe zhvillim dhe anëtar aktual i Bordit, Abdylmenaf Bexheti u zgjodh anëtar i plotë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë. Ai në Akademi tashmë është bashkëakademik me Alajdin Abazin, Rektori *Emeritus* UEJL-së.

Në menaxhmentin e lartë të Universitetit, ka pasur disa ndryshime. Provost i ri është prof. Andrew Goodspeed, Prorektor i ri për ndërmarrësi dhe zhvillim është prof. Mirolub Shukarov dhe Prorektor Blerim Reka ka përfshirë edhe marrëdhëniet ndërkombëtare në portofolin e tij të përgjegjësisë dhe aktualisht shërben si Prorektor për hulumtime dhe marrëdhënie ndërkombëtare.

3.0 Struktura: fakultetet dhe qendrat

Universiteti i Evropës Juglindore ruan të njëjtën strukturë akademike që ka pasur në vitet e fundit. Ka ende pesë fakultete akademike që formojnë thelbin bazë të universitetit: Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore, Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit, Fakulteti juridik dhe Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike. Këto fakultete janë mbështetur nga dy qendrat e pavarura brenda strukturës së Universitetit: Qendra e gjuhëve, e cila ofron mësim të gjuhës për studentët dhe stafin dhe Qendra për eNxënien, e cila ofron trajnime kompjuterike dhe mbështetje. Përveç këtyre ekziston Instituti i mjedisit jetësor dhe i shëndetit që ofron udhëheqje për Universitetin në fushën e administrimit dhe mjedisit dhe zgjidhjet ekologjike, Instituti udhëheq menaxhimin e Plan veprimit klimatik të Universitetit.

3.1 Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë

Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë është fokusuar në përmirësimin e cilësisë, duke përfshirë riakreditimin e të gjitha programeve të ciklit të parë dhe të gjitha programeve të ciklit të dytë me 120 ECTS dhe 60 ECTS; dhe gjithashtu akreditimin e studimeve të ciklit 3 në ekonomi dhe administrim të biznesit. Deskriptorët dhe rezultatet e pritura nga të mësuarit për të gjitha programet studimore janë përgatitur në tri gjuhë dhe të gjitha programet e sapoakredituara dhe riakredituara dhe janë publikuar në faqen e internetit të Universitetit.

Si pjesë e strategjisë së Universitetit për ndërkombëtarizim, një program i ri studimi Master i Administrimit të biznesit MBA - po ofrohet për herë të parë në Universitet. Ky program është një prej një llojit që ofrohet në rajon dhe është paraparë kryesisht për menaxherët e mesëm me përvojë profesionale. Ky program ofrohet në bashkëpunim me Shkollën e biznesit Kelley, Universiteti i Indianës, i cili është një nga shkollat e biznesit lider në nivel botëror. Programi ofrohet në gjuhën angleze. Në vitin e parë të studimeve, ligjëratat do të mbahen në gjuhën angleze nga profesorë lokalë. Vitin e dytë të studimit ligjëratat do të ofrohen nga ligjëruesit nga Shkolla Kelley. Të gjithë studentët që marrin pjesë në këtë program studimi do të marrin një diplomë MBA nga Fakulteti B & E dhe një certifikatë për çdo modul që është ofruar nga Shkolla e biznesit Kelley, Universiteti i Indianës.

Një program për certifikatë për ndërmarrësi dhe zhvillim ekonomik lokal u mbajt në kampusin e Universitetit. Për këtë program, njëzet e pesë të punësuar në komunitat e Tetovës dhe Gostivarit ishin pjesëmarrës. Ky program është në vazhdim.

Në drejtim të hulumtimit dhe zhvillimit, botimet e stafit B & E janë rritur dhe shumica e stafit kanë botuar në revista me referencë ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe, tre anëtarë të stafit akademik B & E ka marrë diplomat e doktoratës dhe një prej tyre është në fazën përfundimtare të një studimi të tillë. Përveç kësaj, katër anëtarët e stafit filluan të ofrojnë trajnim për punonjësit e kompanive lokale dhe kombëtare.

3.2 Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore

Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore ka vazhduar të jetë një nga fakultetet më të mira për shkencat kompjuterike në nivel rajonal. Shkalla e lartë e punësimit të të diplomuarve është një nga treguesit që mbështesin këtë.

Fakulteti organizoi një shkollë intensive verore të organizuar nga . SHTB së bashku me Fakultetin e shkencave dhe inxhinierisë kompjuterike UKIM - Shkup.

Fakulteti gjithashtu ka përparuar në ofrimin e programeve moderne, të dobishme dhe të aplikueshme. SHTB ka hapur programe të reja studimore të ciklit të dytë dhe këto programe tashmë janë aktive.

Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore ka ofruar gjithashtu mundësitë e zhvillimit të stafit. Në nivel të konsiderueshëm, fakulteti ka punuar për të përmirësuar dukshmërinë dhe për të promovuar modulet dhe programet që ofrohen nga fakulteti. Kjo është në përputhje me politikën e Universitetit të rekrutimit të vazhdueshëm dhe me ndërtimin e marrëdhënieve me shkollat dhe palët e interesuara. Së fundi, Fakulteti filloi procesin e krijimit të grupeve kërkimore të bazuara në lëndë dhe ka ndërmarrë një rishikim të plotë të kurrikulave.

Në mënyrë që të përmirësojë cilësinë dhe të zhvillojë standardizimin, SHTB ka miratuar një standard - syllabusin e lëndëve dhe templejt standard për provim. Përveç kësaj, stafi ka rritur pjesëmarrjen e tij në konferenca ndërkombëtare akademike dhe ka përmirësuar shkallën e botimeve në revista shkencore.

3.3 Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit

Në vitin akademik 2011-2012, stafi i Fakultetit të gjuhëve, kulturave dhe komunikimit kanë punuar mjaft në akreditimin e programeve studimore të ciklit të I dhe II dhe fillimin e vitit aktual akademik (2012-13), këto kurrikula janë operative në nivel të fakultetit. Në vitin 2011-12 me sukses u ofrua programi studimor i ciklit të dytë plotësisht sipas modelit online. Shtatë studentë u regjistruan në studimet e magjistraturës online në mësimdhënien e gjuhës angleze (MA-English Language Teaching), projekt ky i cili do të vazhdojë edhe këtë vit akademik, me rritje të numrit të regjistrimeve. Numri i regjistrimeve në ciklin e dytë në studimet e rregullat vazhdon të jetë i kënaqshëm, veçanërisht në anglisht. Megjithatë, në aspektin e numrit të studentëve, regjistrimet në ciklin e parë pësuan rënie, veçanërisht në shkencat e komunikimit. Për fat të mirë, programi i ri Komunikimi ndërkombëtar ka tërhequr një numër të shëndetshëm të studentëve të rinj këtë vit akademik (2012-13). Megjithatë, tendenca në rënie, në programet tjera, sidomos anglisht, mbetet një arsye për shqetësim.

Cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies mbetet e lartë në kuadër të Fakultetit. Anëtarët e Fakultetit GJKK kanë fituar dy çmimet në nivel të universitetit: çmimin për mësimdhënie dhe çmimin për hulumtues të vitit të shpallur në janar 2012. Rezultatet e vëzhgimit kanë qenë vazhdimisht të larta dhe kënaqësia e studentëve gjithashtu mbetet e lartë.

Anëtarët e Fakultetit GJKK ishin të përfshirë në disa projekte të cilat kanë shërbyer për të rritur dukshmërinë e fakultetit dhe të universitetit në komunitet. Praktika ose praktikum për mësimdhënien e gjuhës angleze u prezantua në shkollat e mesme me sukses. Departamenti i gjuhës angleze organizoi një seminar trajnimi në prill 2012, ku morën pjesë mbi 60 mësues të shkollave të mesme. Qendra e re për bashkëveprim dhe dialog kulturor u krijua dhe tri ngjarjet u mbajtën në bashkëpunim me UNESCO-s në kampusin e UEJL. Bashkëpunimi ndërkombëtar vazhdoi ku Departamenti i gjuhës gjermane ka shkëmbyer vizita me Universitetin PHZ me qendër në Zvicër. Shumë anëtarë GJKK kanë kontribuar me punime në Konferencën për sigurimin e cilësisë në qershor në UEJL.

3.4 Fakulteti juridik

Fakulteti juridik ka treguar angazhim të fortë për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve studimore dhe me sukses ka marrë akreditimin zyrtar për programet akademike në tri cikle. Kjo është bërë tërësisht në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë të RM-së, në përputhje të suksesshme me kërkesat për proporcionalitetin 60-30-10 (lëndët e detyrueshme zgjedhore - zgjedhore të lira). Ky proces arriti kulmin ku me sukses u pranuan vendimet përkatëse të Këshillit të akreditimit të shtetit.

Në mënyrë që të ofrojë cilësinë më të lartë të mësimin, fakulteti ka vazhduar ta angazhojë stafin e vet të shquar, por ka angazhuar edhe profesorë eminentë nga rajoni në të dy ciklet, të parin dhe të dytin. Stafi është inkurajuar të prodhojë hulumtime të kualitetit të lartë dhe këtë vit ka parë përmirësime në publikimin e artikujve shkencorë në revista lokale dhe ndërkombëtare

Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të fakultetit për mësim praktik dhe të aplikuar, Fakulteti i drejtësisë ka angazhuar gjyqtarë, avokatë, ekspertë të mjekësisë ligjore, prokurorë, noterë, përfaqësues të zyrës së Avokatit të popullit, përfaqësues të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve si dhe përfaqësues të komunave për të ligjruar para studentëve tanë. Shumë nga këta ekspertë na kanë ndihmuar gjithashtu në përputhje të plotë me kërkesat ligjore për mësimin "klinik" (mësimdhënie nga ekspertë të jashtëm të verifikuar).

Fakulteti, gjithashtu, është angazhuar në një vizitë studimore me studentët dhe profesorët në Gjermani. Atje ata vizituan Bundestagun dhe Bundesratin si dhe fakultetet juridike në Berlin dhe Hamburg dhe Institutin e të drejtës ndërkombëtare dhe krahasuese "Max Planc", gjithashtu në Hamburg.

Fakulteti Juridik mbetet i angazhuar për marrëdhënie të suksesshme me studentët dhe rekrutimin e studentëve më të mirë. I gjithë stafi duhet të mbajë konsultime javore me studentët, të cilat janë të monitoruara nga dekanati. Dekanati ka formuar edhe një ekip të posaçëm për rekrutimin studentëve dhe marketingun e fakultetit në shkollat e mesme në rajonin e Tetovës-Gostivarit.

Së fundi, Fakulteti juridik është i kënaqur me ruajtjen e suksesshme të numrit të përgjithshëm të studentëve në programet studimore drejtësi dhe kriminalistikë, pavarësisht numrit të madh të programeve konkurruese në vend.

3.5 Fakulteti i Administrimit publik dhe shkencave politike

Fakulteti i administrimit publik dhe i shkencave politike vazhdon të rishikojë programet në përputhje me ndryshimet në tregun e punës. Fakulteti është veçanërisht i interesuar në nxitjen e programeve të reja të cilat do të ofrohen në bashkëpunim me universitetet e tjera. Prandaj, fakulteti aktualisht ofron një program studimor *Lidershipi dhe puna rinore në komunitet*, në bashkëpunim me Universitetin e Jönköping, Suedi (diplomë e dyfishtë) dhe paralelisht Fakulteti ka themeluar grupe të përbashkëta pune për të ofruar një program të përbashkët me Universitetin e Lubjanës (Fakulteti i shkencave sociale). Ky program i përbashkët do të jetë në fushën e Studimeve evropiane dhe do të dizajnohet që të ofrojë përmbajtje të cilat do t'u adresohen kapaciteteve të administratës shtetërore për të tërhequr fondet e BE-së dhe kuadro që do të punojnë në institucionet e BE-së për procesin e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në BE. Është planifikuar që ky program të ofrohet në Bordin e akreditimit në dhjetor 2012 dhe të ofrohet në vitin akademik 2013/2014.

Fakulteti me vendosmëri do t'i ndjekë mundësitë ndërkombëtare dhe për këtë arsye Fakulteti i APSHP ka nënshkruar një marrëveshje Erasmus Mundus me Fakultetin e shkencave sociale për mobilitetin e pesë anëtarëve të stafit mësimdhënës gjatë viteve 2012-2014. Ajo ka për qëllim të promovojë karakterin ndërkombëtar të Fakultetit si dhe përmirësimin e kapaciteteve të stafit të mësimdhënies.

Fakulteti ka akredituar dhe tani ofron një program të ri në ciklin e dytë *Zhvillimi i shoqërisë civile*. Ky program është krijuar në bashkëpunim me Qendrën për zhvillim institucional. Programi ka për qëllim të mbulojë hendekun në edukimin formal e punëtorëve të OSHC-ve, aktivistë dhe vullnetarë dhe të forcojë kapacitetet e tyre për të ndërtuar demokracinë efektive në rajon. Kjo do të ndihmojë që ata të promovojnë rolin dhe vlerat e organizatave të shoqërisë civile në zhvillimin e demokracive moderne. Gjuha e punës në këtë program është anglishtja.

Fakulteti ka kërkuar të bëjë lidhjen në mes deskriptorëve të lëndës me ekspertizën e ligjëruesve në një mënyrë më të rafinuar dhe të saktë. Ata kanë ndërmarrë një sërë iniciativash me mbështetjen dhe kontributin e grupeve të disiplinës për të krijuar këto lidhje. Kjo është bërë për të përmirësuar cilësinë e ofertës akademike të fakultetit.

Së fundi, Fakulteti ka vendosur një theks të rëndësishëm në monitorimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Përfaqësuesit e APSHP u takuan së bashku me përfaqësuesit e komunitetit lokal dhe studentët për të krijuar pikat e forta dhe dobësitë e Fakultetit. Ky doli të jetë një mekanizëm i rëndësishëm korrigjues dhe një mekanizëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxëniet në Fakultet.

3.6 Qendra e gjuhëve

Qendra e gjuhëve vazhdon të jetë një nga njësitë akademike më të gjalla brenda Universitetit, duke reflektuar orientimin shumëgjuhësor dhe multikulturor me studentët nga të gjitha fakultetet dhe prejardhje të ndryshme që ndjekin mësimin e gjuhës së bashku. Qendra ka një staf të përkushtuar dhe mënyrë interaktive të mësimdhënies dhe është vendosur për të ofruar shërbim efikas administrativ për studentët. Qendra, gjithashtu është nikoqire e disa klubeve të ndryshme që kanë kontribuar në pasurimin e jetës sociale të studentëve në kampus: klubin e dramës, klubet sportive, klubin e fotografëve dhe alumni i SHBA-ve. Duke shfrytëzuar kontakte të ngushta me studentët, QGJ ka organizuar një konkurs të rëndësishëm rajonal për ese, që përfundoi me një ceremoni të madhe në ndarjen e çmimeve; dhe në Panairin e gjuhëve ku morën pjesë më shumë se 300 nxënës nga shkollat e mesme të rajonit, të cilët u mirëpritën dhe u argëtuan nga studentët e UEJL-së.

Në rrafshin akademik, QGJ me sukses ka rishikuar kurrikulat dhe metodat e testimit në tri programet kryesore anglisht, shqip dhe maqedonisht si dhe ka zgjeruar ofertën me lëndët “zgjedhore të lira” anglisht, shqip, maqedonisht, gjermanisht, frëngjisht. Në mënyrë që të rritet komponenta praktike e lëndëve të gjuhës dhe të vihet në fokus më të madh aftësia komunikuese e studentëve, provimet finale me gojë u organizuan për të gjitha lëndët. Përveç kësaj, është organizuar testimi përfundimtar në gjuhën shqipe dhe maqedonase i përkrahur në platformë kompjuterike dhe testimi final në anglisht është testuar në fazën pilot për lëndën gjuhë angleze, niveli fillestar. Rezultatet e këtij testimi treguan se 92% të studentëve kanë përmirësuar shkathtësitë e tyre në anglisht, pas kompletimit të kursit njësemestral në Qendrën e gjuhëve. Këto të dhëna janë të destinuara për t'u përdorur si tregues për progresin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies dhe për rishikimin e programeve studimore. Si një qendër e licencuar për para-testim për IELTS, qendra u ka ofruar studentëve mundësi për të kontrolluar njohuritë e tyre përmes këtij testimi të standardizuar në anglisht dhe rezultatet ishin më shumë se të kënaqshme.

Qendra ka bërë progres të rëndësishëm me programet që tregojnë interesim të veçantë për komunitetin e jashtëm. Edhe pse kursi CELTA nuk ishte aktiv për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve, ka pasur dy seanca të një kursi përgatitor TOEFL. Përveç kësaj, QGJ fitoi tenderin e hapur për ofrimin e kurseve të gjuhës shqipe për stafin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shkup.

3.7 Qendra për eNxënie (eLearning Centre)

Qendra për eNxënie në Universitet ofron kurse trajnimi që u japin studentëve shkathtësitë kompjuterike të cilat janë të detyrueshme për të përmbushur sfidat e tanishme dhe të ardhshme teknologjike në vendin e punës.

Qendra për eNxënie ofron një mori të temave të lëndëve zgjedhore të lira me qëllim që përmbushë shumëllojshmërinë e niveleve të shkathtësive dhe interesave. Kurset hyrëse ofrohen për ata studentë që kërkojnë njohuri themelore, ndërsa kurset e avancuara aktuale të aplikacioneve TI ofrohen për studentët me nevoja më të specializuara.

Të gjitha këto kurse ofrohen për stafin akademik dhe administrativ. Qëllimi është që të sigurohen njohuritë teknike, shkathtësi dhe përvoja që do të rrisin vlerën e secilit anëtar të komunitetit të UEJL-së në institucion dhe në të njëjtën kohë për të rritur zhvillimin e tyre profesional.

Studimet ONLINE që kanë filluar të ofrohen nga viti 2011 vazhdojnë të jenë një nga fokuset kryesore të Qendrës për eNxënie. Në vitin e dytë të ofrimit të këtij modeli të studimeve online instrumentet e mësimdhënies dhe metodologjitë vazhdojnë.

3.8 Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit

Ngjarje kryesore për Institutin e mjedisit jetësor dhe shëndetit në këtë periudhë ishte hapja zyrtare e Ndërtesës për efikasitetin e energjisë në kampusin e UEJL-së në Tetovës. Kjo ndërtesë është një model inovativ i të kuptuarit të tanishëm të arkitekturës të qëndrueshme mjedisore dhe është ndërtesë unike në hapësirën e arsimit të lartë në Maqedoni. Ndërtesa - aktualisht është selia e Institutit dhe është ekologjikisht-neutrale. Ajo ka një ndikim minimal mjedisor. Ngritjen e kësaj ndërtese e ka përkrahur Ambasada e Italisë dhe Ministria e Mjedisit e Maqedonisë.

Instituti gjithashtu ka ofruar trajnime për stafin e UEJL në uljen e ndikimit të tyre mjedisor. Si rezultat i diskutimeve që pasuan, Universiteti ka miratuar "Kodin e mjedisit" i cili inkurajon menaxhim të mirë të mjedisit. Udhëzimet thelbësore nga ky kod janë postuar në të gjitha zyrat dhe klasat në Universitet, në tri gjuhët zyrtare që përdoren në nivel të universitetit.

Universiteti vazhdon të ruajë koshat për riciklimin e letrës në të gjitha ndërtesat kryesore administrative dhe mësimore.

4.0 Sigurimi i cilësisë

Renditja në vend e dytë të Universitetit në mesin e nëntëmbëdhjetë institucioneve të arsimit të lartë përfaqëson një njohje shumë të mirë për punën dhe zhvillimin e një kulture të përgjithshme të cilësisë.

Bordi i Universitetit ka ofruar monitorimin e rregullt të planeve të universitetit dhe ka insistuar në zbatimin e kërkesave për kontroll cilësor të të dhënave të verifikueshme në fushat e menaxhimit të performancës, auditimit financiar të Universitetit dhe planifikimit, në vlerësimin e stafit dhe proceset punësimit dhe për zhvillimin akademik. Komitetet e Bordit si Komiteti për çështje të stafit dhe Komiteti për auditim dhe menaxhim të rrezikut shpesh kanë mbikëqyrur grumbullimin dhe analizën e këtyre të dhënave. Bordi është duke punuar në përpilimin e planit të ardhshëm strategjik, që bazohet në të arriturat dhe lëmenjtë aktuale për përmirësim.

Komiteti për çështje të stafit ka konstatuar se rregulloret e Universitetit janë rishikuar, publikuar dhe implementuar dhe se Universiteti edhe njëherë është licencuar me standardin ISO 9001:2008, standard i jashtëm ky për menaxhim të performancës. Promovimet e para në thirrje sipas rregullores së rishikuar dhe formularëve templejt janë realizuar dhe këto ishin të kënaqshme. Gjithashtu, raporti vjetor për punësim tregon se vendet e lira administrative janë plotësuar në bazë të një procesi të rreptë, të hapur dhe transparent. Sistemi i vlerësimit më aktiv (vlerësimi i stafit) tashmë është në vitin e dytë të operimit për të gjithë stafin, me trajnimin e duhur të vlerësuesve. Cilësia e raporteve është duke u moderuar për analizë dhe përmirësim.

Për periudhën që mbulohet nga ky raport, ekipi ekzekutiv i rektorit, çdo fakultet, qendër dhe departament administrativ kanë përpiluar planveprimet e tyre për të përcaktuar dhe harmonizuar veprimtaritë e tyre profesionale për vitin e ardhshëm. Secili plan është moderuar dhe progresi është kontrolluar nga rektori ose provosti. Rektori ka prezantuar planet e ekipit ekzekutiv për stafin, në një takim kolektiv dhe çdo njësi ka konsultuar stafin e vet në përgatitjen dhe zbatimin e planit.

Lidhur me kurrikulat, çdo fakultet ka shqyrtuar kurrikulat e veta në përputhje me kërkesat ligjore dhe këto janë akredituar me sukses nga ana e Bordit të akreditimit dhe vlerësimit. Përveç kësaj, në trajnimin e gjithë stafit në janar dhe gusht, është bërë punë e mëtijshme në përdorimin aktiv të rezultateve të të nxënit lidhur me vlerësimin.

Këshilli i Rektorit ka ruajtur rolin e tij si një trup për diskutim, qarkullimin e informacionit dhe këshilla në lidhje me çështjet akademike, ndërsa Kolegjiumi ka funksionuar në mënyrë efikase si forum menaxherial për udhëheqësit administrativë, i udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm.

Për sa i përket strukturës së sigurimit të cilësisë, politikës së cilësisë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me Planin strategjik të Universitetit, Komisioni për sigurimin dhe menaxhimin e cilinës (KSMC) vazhdoi monitorimin e planit dhe me rolin e përgjegjës në lidhje me funksionin efektiv dhe ndërlidhjes efikase në mes të ekipeve të sigurimit cilësisë akademike dhe administrative. Zyra për sigurimin e cilësisë ka operuar proceset kryesore të cilësisë si: vëzhgimin e mësimdhënies, vlerësimin nga studentët dhe procedurat për menaxhimin e performancës dhe ka shërbyer si koordinator i aktiviteteve operative. Ajo ka siguruar të dhëna kryesore dy herë në vit për analizë nga fakultet/departamentet. Këto të dhëna pas kompletimit u janë dërguar njësive relevante për përdorim. Zyra gjithashtu ka ofruar përkrahje për Unionin e studentëve në përpilimin e rregullores së re për Parlamentin studentor dhe Asociacionin e studentëve. “Kampioni i cilësisë”, i jashtëm, ka realizuar dy vizita dhe ka siguruar raporte vlerësuese me rekomandimet e nevojshme për të dyja rastet. Ekipet e cilësisë kanë qenë më funksionale në departamentet administrative, por jo edhe aty në fakultete.

Në qershor 2012, Zyra për sigurimin e cilësisë, me një komision udhëheqës me sukses kanë koordinuar Konferencën nacionale për Sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe nxënie ku të pranishëm ishin afro 200 pjesëmarrës, me dy moderatorë ndërkombëtarë mjaft të respektuar në këtë lëmi dhe afro 40 prezantime me një mori të temave.

Rekomandohet që universiteti të vazhdojë për të maksimizuar përdorimin aktiv të proceseve të cilësisë me qëllim që të maksimizojë vlerën e tyre, të përqendrohet në përfshirjen edhe më të madhe të studentëve dhe të zhvillojë iniciativat autonome të cilësisë me ekipet më të forta të cilësisë, sidomos në fakultete.

5.0 Mësimdhënia dhe nxënia

5.1 Programet dhe statusi

Të gjitha fakultetet e UEJL-së kanë vazhduar të ofrojnë programe studimore të ciklit të parë dhe të dytë gjatë periudhës të mbuluar me këtë periudhë. Në ndërkohë, të gjithë fakultet kanë kompletuar rishikimin e plotë të kurrikulave dhe kanë dorëzuar për akreditim programet e ciklit të parë dhe të dytë në Bordin e akreditimit; të gjitha programet e reja janë akredituar me sukses dhe gjeneratat e reja-vitet e para në vitin akademik 2012-2013 do të studiojnë me sipas këtyre programeve.

Universiteti gjithashtu është pionier në ofrimin programeve studimore ekskluzivisht online në ciklin e dytë dhe këto janë menaxhuar me sukses nën mbikëqyrjen e fakulteteve relevante dhe Qendrës për eNxënie.

Cikli dytë i studimeve vazhdon të jetë një pjesë e rëndësishme e ofertës akademike të Universitetit. Këto në përgjithësi janë programe mjaft popullore, mirëpo Universiteti ka konstatuar se një numër i mjaft i lartë i studentëve i kalojnë provimet, ndërkaq nuk kanë mbrojtur publikisht tezën e tyre. Provosti do të angazhohet gjatë vitit 2012-2013, t'i kontaktojë këta studentë, do t'u ofrojë atyre të riintegrohen në proces përsëri ose ndryshe përfundimisht do të jenë studentë joaktivë.

Programet studimore me korrespondencë gjithashtu vazhdojnë të tërheqin studentë numri i të cilëve është në rritje dhe këto programe menaxhohen nga fakultetet gjegjëse. Këto programe tërheqin studentë nga grupet e ndryshme jetësore, nga ata që jetojnë jashtë shtetit, profesionistë të cilët janë në marrëdhënie pune dhe përkushtimi i tyre nuk i mundëson të ndjekin studimet e rregullta. Universiteti shpreson ta rrisë numrin e këtyre programeve, pasi me këtë mënyrë të studuarit oferta akademike e UEJL-së është e qasshme për një numër të madh të popullatës të cilët nuk mund të ndjekin studimet e rregullta.


5.2 Regjistrimi i studentëve

Në vitet e fundit, numri i studentëve shënon rënie (Tabela 5.20). Universiteti ka identifikuar disa arsye për këtë rënie: disperzimi i universiteteve, fakulteteve dhe programeve — së bashku me uljen e pagesës së shkollimit nga universitetet publike — si rezultat regjistrimi në universitetet private në Republikën e Maqedonisë në përgjithësi është në ulje, por edhe stagnimi ekonomik i vendit dhe rajonit pasqyrojnë krizën e vazhdueshme financiare në të gjithë botën. Edhe pse nuk është identifikuar një arsye e veçantë për rënien e numrit të regjistrimeve, të gjitha arsyet e mësipërme duket se janë kontribuues në rënien e regjistrimeve të studentëve.

Viti akademik	Numri i studentëve
2009/2010	1889
2010/2011	1595
2011/2012	1280
Gjithsej	4764

Tabela 5.20 Numri i përgjithshëm i regjistrimeve sipas viteve akademike

Grafikoni 5.21 ilustron trendet në ulje të regjistrimeve bazuar në gjuhën e studimit. Programet studimore që ofrohen në gjuhën shqipe dhe maqedonase shënojnë rënie në vitet akademike 2009/2010 dhe 2010/2011, kurse programet studimore në gjuhën angleze shënojnë rritje. Kjo i atribuohet cilësisë së lartë të programeve që ofrohen anglisht dhe njohjes në rritje në RM se *lingua franca* për biznes, tregti, turizëm, menaxhim e informacion dhe diplomaci ndërkombëtare është gjuha angleze.



Grafikoni 5.21 Numri i përgjithshëm i regjistrimeve (cikli i parë dhe dytë)

Numri i përgjithshëm i regjistrimeve në tabelën 5.22 tregon rënie në tri vitet e fundit. Ashtu siç mund të shihet, rënie më të lartë ka në Fakultetin e administrimit publik dhe shkencave politike, kurse rënie më të ulët në Fakultetin juridik. Nga të gjitha fakultetet është kërkuar të analizohen këto të dhëna dhe të fillojnë me procesin e ‘rekrutimit të vazhdueshëm’, pra me aktivitetet e drejtpërdrejta dhe indirekte promovuese (si garat për ese, vizitat në shkollat e mesme, nikoqir i tryezave të ndryshme ose pjesëmarrje në panairë, etj.). Kjo duhet të ndërmerret në bashkëpunim me Zyrën për informim dhe promovim.

Fakulteti	2009/2010	2010/2011	2011/2012
BE	393	364	273
SHTB	294	235	208
Juridiku	356	320	274
GJKK	314	301	207
APSHP	532	375	318
Gjithsej	1889	1595	1280

Tabela 5.22 Numri i përgjithshëm i regjistrimeve sipas fakulteteve

5.3 Shkalla e kalueshmërisë së studentëve

Shkalla e kalueshmërisë së studentëve është përgjegjësi kryesore e cilitdo universitet. Ajo i referohet shkallës së suksesit të studentëve. Ata studentë të cilët vazhdojnë programet e tyre studimore, akumulojnë të gjitha (ose shumicën) e kredive ECTS të pritura për të vazhduar në vitin e ardhshëm dhe të vazhdojnë me programet e tyre, konsiderohen si studentë që kanë kaluar shkallën e kalueshmërisë. Studentët që tërhiqen nga Universiteti, për çfarëdo arsye, konsiderohen si studentë që nuk kanë kaluar shkallën e kalueshmërisë.

Një vështirësi në vlerësimin e këtyre të dhënave qëndron në këmbënguljen e konceptit të 'provimet make-up.' Këto janë sesione provimesh, që administrohen disa herë gjatë vitit akademik, ku studentët që nuk kanë kaluar me sukses provimet u jepet mundësia që të bëjnë këtë në këto sesione të veçanta. Në praktikë, kjo është treguar të jetë më shumë iluzore se faktike; studentët të cilët shpesh kanë rënë nga provimi nuk përgatiten në mënyrë adekuate për këto provime, të cilat janë vetëm arsye etike. Nga stafi akademik është kërkuar të thirren studentët të marrin pjesë në "orët e konsultimit" dhe për këtë arsye Universiteti ka organizuar një 'shkollë verore' për të ndihmuar studentët në përgatitjet e tyre për këto teste. Megjithatë, kjo është për të ardhur keq se në të vërtetë vetëm disa studentë përfitojnë nga këto mundësi dhe kështu ata hyjnë me shpresë, por pa u papërgatitur sesionet e provimeve 'make-up'.

Në tabelën në vazhdim është dhënë shkalla e kalueshmërisë për gjeneratën 2009/10 e cila është 73% në nivel të Universitetit.

Gjenerata 2009/10	Studimet e rregullta Regjistrimet 2009/10	Kalueshmëria 2010/11		Kalueshmëria 2011/12	
		Studentët	Kalueshmëria në vitin e dytë	%	Kalueshmëria në vitin tretë
BAE	199	160	80%	143	72%
CST	207	174	84%	140	70%
LAW	186	164	88%	129	72%
PAPS	312	268	86%	237	77%
LCC	164	133	81%	111	69%
Gjithsej	1068	899	84%	732	73%

Tabela 5.30 Shkalla e kalueshmërisë për gjeneratën 2009/10

Në gjeneratën 2010/11 ka 893 studentë të rregullt të regjistruar për herë të parë, nga këta 83% kanë kaluar në vitin e dytë; kurse 68% në vitin e tretë (në nivel të Universitetit). Kjo është padyshim një çështje për përmirësim, pasi kjo do të thotë se më shumë se tre në çdo dhjetë studentë bien në pasivitet gjatë karrierës së tyre akademike në UEJL. Në vitin akademik 2012-2013, Provosti do të udhëheqë një nismë të madhe-bashkëpunim me fakultetet, këshilltarët studentorë, Qendrën e karrierës dhe alumnin për të gjetur shkaqet themelore për një rënie të tillë.

Gjenerata 2010/11	Studimet e rregullta Regjistrimet 2010/11	Kalueshmëria 2011/12		Kalueshmëria 2012/13	
BE	173	147	86%	107	62%
CST	165	132	80%	114	69%
LAW	185	154	83%	119	64%
PAPS	199	157	79%	138	69%
LCC	171	149	87%	128	75%
Gjithsej	893	739	83%	606	68%

Tabela 5.31 Kalueshmëria për gjeneratën 2010/11

5.4 Shkalla e diplomimit

Shenja themelore e suksesit në çdo universitet është norma e diplomimit. Kjo regjistron numrin e studentëve të cilët me sukses të plotë, në periudhën kohore të prishme, kompletojnë ofertën akademike ashtu siç është akredituar nga qeveria. UEJL ndjek arritjen e studentëve të rregullt dhe në këtë seksion shkalla e diplomimit për studentët e gjeneratës 2009/10 është paraqitur. Në gjeneratën 2009/2010 vetëm 21% e studentëve kanë diplomuar në kohë, 63% nuk kanë diplomuar ende dhe 16% janë joaktivë ose janë tërhequr. Krahasuar me gjeneratën paraprake 2008/09, kjo gjeneratë ka një rrënie të lehtë në përqindjen e studentëve që diplomojnë në kohë, e cila është 2% më pak se gjenerata paraprake (23% kanë diplomuar në kohë).

Kur bëjmë vlerësimin e shkallës së diplomimit në kohë në nivel fakulteti, nga të dhënat shihet se shkalla më e ulët është në SHTB dhe juridik (vetëm me 13%), ndjekur nga APSHP (me 23%). B&E dhe GJKK kanë shkallë më të mirë të diplomimit në kohë, me 36%.




Figure 5.40 Shkalla e diplomimit sipas fakultetit për gjeneratën 2008/2009

Shkalla e diplomimit në ciklin e dytë çon në konkluzione paksa të ndryshme. Sipas të dhënave për numrin e studentëve të UEJL-së të cilët kanë diplomuar në programet e ciklit të dytë është 19% (ose 403 studentë) nga numri i përgjithshëm i studentëve në ciklin e dytë. APSHP ka numrin më të lartë të studentëve që diplomojnë në ciklin e dytë 196 (36% nga numri i përgjithshëm i tyre). Në GJKK kanë diplomuar 87 studentë (24% nga numri i përgjithshëm i tyre). Në SHTB kanë diplomuar 59 studentë (21% nga totali i tyre). Në B&E kanë diplomuar vetëm 42 studentë (8% nga numri i përgjithshëm i tyre). Deri më 30 gusht 2012, vetëm 19 studentë kanë diplomuar në Fakultetin Juridik, e shprehur në përqindje është 8% nga numri i përgjithshëm i tyre.


Që të adresohet ky boshllëk befasues midis fillimit të studimeve dhe përfundimit të studimeve të ciklit 2, dekanët dhe provosti do të udhëheqin një iniciativë të konsiderueshme për të kontaktuar studentët të cilët nuk kanë mbrojtur tezën dhe përpjekjet për riintegrimin e tyre në ofertën e akademike të ciklit. Kjo do të shoqërohet me krijimin e një afati të caktuar ku studentët duhet të dorëzojnë tezën e magistraturës ose ndryshe studentët do të konsiderohen 'joaktivë.'

5.5 Vlerësimi i stafit akademik nga studentët

Çdo vit përgatitjet për procesin e vlerësimit nga studentët fillojnë në mars. Procesi realizohet në prill për ciklin e parë dhe maj për ciklin e dytë.

Ky proces koordinohet nga një ekip i krijuar nga anëtarët e Zyrës për sigurimin e cilësisë, Shërbimi studentor dhe këshilltarët studentorë. Ekipi ka realizuar këtë proces në mënyrë efikase duke mbështetur njëri-tjetrin dhe duke ofruar ekspertizën e tyre përkatëse. Ky proces përmban aktivitete të shumta të dallueshme dhe është shumë i rëndësishëm për Universitetin, pasi është mënyrë numër një (e drejtpërdrejtë) për të vlerësuar kënaqësinë e studentëve për instruktorët, lëndët e tyre dhe Universitetin në përgjithësi.

Rezultatet nga vlerësimi i studentëve për stafin akademik janë proceduar nga Shërbimi studentor në mënyrë konfidenciale, raportet individuale janë dërguar nga Zyra për sigurimin e cilësisë deri tek anëtarët e stafit dhe tek ekipi ekzekutiv i rektorit, Zyra e burimeve njerëzore dhe dekanët ose drejtorët gjegjës. Dekanët ose drejtorët më pas kanë përdorur këto raporte në takimet e vlerësimeve vjetore (vlerësimi i stafit) me stafin akademik.



Grafikoni 5.50 Rezultatet nga procesi i Vlerësimit të stafit akademik nga studentët

Siç mund të shihet nga grafikoni (5.60), Universiteti ka treguar përmirësim në vlerësimin nga studentët në vitin akademik 2011-2012. Kjo është e lavdërueshme, edhe pse ka disa fusha ku Universiteti vazhdon të ketë rënie në kënaqësinë e studentëve. Megjithatë, prirja e përgjithshme, siç dëshmohet këtu, është drejt rritjes së kënaqësinë nga studentët. Rezultatet nga anketa për vitin 2011-2012 janë të gjithë më të larta se në vitin e kaluar, dhe këto të dhëna janë inkurajuese.

5.6 Qendra e karrierës

UEJL në Tetovë është selia e Qendrës së karrierës e cila ofron udhëzime për karrierën, këshilla për kërkim të punës dhe trajnim për studentët Universitetit. Qendra ofron këshillime individuale dhe grupore si p.sh. si të shkruarit e CV, letrës përcjellëse, teknikave të intervistimit, etj. Përveç kësaj, Qendra menaxhon punën praktike të studentëve (internship) dhe kërkesat për trajnim praktik. Qendra organizon dhe është nikoqire e panairit vjetor të karrierës. Më e rëndësishme, Qendra e karrierës gjithashtu raporton për aftësinë e të diplomuarve të UEJL-së për të gjetur punë, si në Maqedoni dhe jashtë vendit. Rezultatet e këtij studimi janë dhënë në anketën destinomi i alumni-it të UEJL-së. Të gjeturat kryesore nga ky raport tregojnë se studentët e UEJL vazhdojnë të jenë të punësuar në një normë më të lartë sesa mesatarja e vendit.

Lidhur me notën mesatare, të diplomuar me notë mesatare kumulative në mes 7 dhe 8, dhe ato në mes të 8 dhe 9, përjetojnë një normë të punësimit prej 45%, ndërsa të diplomuarit me notë mesatare midis 9 dhe 10 përjetojnë një normë të punësimit prej 41%.

Sipas të diplomuarve të punësuar, 32.22% e tyre kanë mësuar në lidhje me pozitën e tyre aktuale të punës nga një anëtar i familjes, ndërsa 16.27% e tyre nga njoftimet e Qendra së karrierës, 15.94% e tyre kanë mësuar për pozicionin e tyre të punës nga Interneti, dhe 13,28% e tyre nga shtypi.

5.7 Asociacioni i alumni-t

UEJL tashmë ka përvojë dhjetë vjeçare dhe ka një trup të diplomuarve në rritje. Asociacioni i Alumni-t është një trup që ka për qëllim të mbajë lidhjet ndërmjet Universitetit dhe studentëve të tij të diplomuar. Udhëhiqet nga statuti dhe ka statusin e një organizate të pavarur në kuadër të Universitetit.

Rolet kryesore të Asociacionit të alumni-t janë për të mbajtur kontakte me ish studentët e Universitetit, për të ndihmuar në promovimin e Universitetit; për të siguruar koment dhe sugjerime për oferta akademike aktuale ose të parashikuara dhe për të ruajtur frymën kolektive të institucionit. Gjithashtu shërben si një mënyrë në të cilën një individ apo alumnus ose alumna mund të vazhdojë të mbështesin Universitetin pas diplomimit të tij ose të saj.

Zgjedhjet e reja për Bordin e Asociacionit Alumnit priten të mbahen në fund të vitit 2012 dhe anëtarët e sapozgjedhur të bordit do të angazhohen në një shumëllojshmëri të gjerë të aktiviteteve, duke përfshirë organizimin e ngjarjeve Alumnit, duke kontribuar në mekanizmat vlerësuese në universitet, si dhe duke ndihmuar në ngjarjet promovuese të Universitetit në bashkëpunim me Zyrën për informim dhe promovim.

Universiteti organizoi një takim të veçantë me Alumnin në Prishtinë gjatë periudhës së këtij raporti. Kjo ngjarje lejoi të që diplomuarit të takohen, të festojnë, të socializohen me të diplomuar të tjerë dhe për të ruajtur lidhjet e tyre me UEJL-në.

6.0 Hulumtimi

Zyra për hulumtime gjatë këtij viti akademik vazhdoi veprimtarinë e saj për ndërtimin e profilit të UEJL-së si institucion hulumtues i arsimit të lartë. Përmes mbështetjes së stafit akademik për realizimin e veprimtarisë së tyre hulumtuese, Zyra për hulumtime vazhdon të ofrojë përkrahje administrative.

Për periudhën 2013-2016 është duke u zhvilluar një strategji e re hulumtuese, ku është shprehur qartë përkushtimi i UEJL-së ndaj hulumtimit si pjesë thelbësore e misionit të tij. Veprimtaria hulumtuese në UEJL do të vazhdojë të jetë element kyç i të gjitha detyrave të stafit akademik, në besimin se një kulturë hulumtuese aktive dhe vitale është në dobi të gjitha sferave të studimeve në Universitet.

Në periudhën e mbuluar nga raporti UEJL ka themeluar dy institute hulumtuese si njësi akademike të Universitetit. Misioni i Institutit “Max van der Stoel” është zhvillimi dhe organizimi i aktiviteteve arsimore dhe hulumtuese në fushën e shkencave humane: shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare, drejtësi dhe administratë publike (me fokus të veçantë në diplomacinë parandaluese, ripajtimi ndërkulturor dhe parandalimi i konfliktit). Instituti është emëruar në nder të njërit nga themeluesit e Universitetit, Max van der Stoel. Instituti i dytë - Instituti për hulumtime të aplikuara në biznes dhe informatikë është themeluar që të inkurajojë hulumtimet e aplikuara të kapacitetit akademik dhe institucional të UEJL-së në fushat e ndërlidhura të biznesit dhe informatikës, si dhe në informatikë të biznesit. Misioni i Institutit është të forcojë kapacitetet në mënyrë që të zhvillojë një klimë ekonomike të bazuar në dije dhe informacion dhe për të nxitur që biznesi, njerëzit dhe sistemet të bëhen më funksionale, ndërvepruese dhe të përshtatshme ndaj konteksteve moderne që ndryshojnë vazhdimisht.

Nga viti akademik 2010/2011, UEJL mbështet financiarisht të gjithë hulumtuesit individualë nga kuadri akademik për pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore ndërkombëtare. Gjithashtu, duke filluar nga viti akademik 2011/2012, u prezantua një instrument i ri për të promovuar botimin e punimeve shkencore duke inkurajuar stafin e ri në veçanti, përmes përshtatjes së përgjegjësive të mësimdhënies dhe shpërblimit për ata punimet e të cilëve janë pranuar për t'u botuar në revista ndërkombëtare të listuara në Thomson Reuters Web of Sciences (si një nga treguesit më të rëndësishëm për rangimin e universiteteve). Në gjithashtu kemi të përfshirë në thirrje publike për Projektet FP7.

Për herë të parë, në vitin akademik 2012/2013, UEJL është përgatitur që të fillojë me Shkollën e doktoratës, me qëllim që të lidhë hulumtimet me programin studimor tre vjeçar të Shkollës së doktoratës.

Risi në UEJL është se që nga viti akademik 2012/2013 do të fillojë botimi *on-line* i revistës shkencore "SEEU Review" në VERSITA – botuesi i dytë më i madh në botë me qasje të hapur. Baza e të dhënave për hulumtim e UEJL-ës tash më funksionon.

Universiteti ka vazhduar traditën e tij të përkrahë publikimin e hulumtimeve cilësore. Gjatë vitit akademik 2011-2012 Universiteti ka mbështetur botimin e 20 librave. Këto vepra kanë ardhur nga fakultetet e mëposhtme në këtë raport: 10 nga Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë, 2 nga Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore, 5 nga Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit dhe 3 nga Fakulteti administrimit publik dhe shkencave politike.

6.1 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare ka punuar vazhdimisht për të rritur vetëdijësimin e studentëve dhe anëtarëve të stafit në lidhje me mënyrat e ndryshme të gjetjes bursë për të studiuar jashtë vendit; këto aktivitete ishin shpërndarë përgjatë gjithë vitit.

Këto aktivitete u fokusuan për të krijuar mundësi për bursë për studentët tanë për të studiuar jashtë vendit (duke kontribuar kështu në mobilitetin) në Gjermani, Francë apo në Mbretërinë e Bashkuar. Prezantime të ndryshme u organizuan gjatë gjithë vitit për studentët e ciklit të parë dhe të dytë në nivel të Universitetit. Studentët janë dërguar në panairin *Scholarships Expo* në Shkup dhe ku janë ndihmuar skemat për mobilitet në të cilat UEJL është partner, duke përfshirë Basileus, JoinEuSee bazën e të dhënave për bursa S4WB. Të gjitha këto aktivitete në mënyrë bujare janë ndihmuar nga fondacioni "*King Baudouin Foundation*".

Në mars të vitit 2012, Universiteti ka aplikuar në Agjencinë kombëtare për programet studimore evropiane dhe mobilitetin e studentëve për fonde Erasmus për shkëmbimin e studentëve dhe kemi marrë 171 muaj për studentët dhe një mobilitete për anëtarin e stafit të UEJL-së. Për të lehtësuar këto mobilitete Universiteti ka lidhur marrëveshje bilaterale me universitetet partnere evropiane të cilët pranuan të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe Erasmus për të marrë studentët e UEJL-së për një ose dy semestra. Deri tani Universiteti ka nënshkruar gjithsej 5 marrëveshjeve dypalëshe Erasmus me universitetet e mëposhtme: Universiteti SMK i Shkencave të aplikuara sociale në Lituani, Universiteti i Foxhias në Itali, Universiteti i Goteborgut në Suedi dhe Universiteti i Primorjes dhe Universiteti i Lubjanës në Slloveni.

7.0 Ndërmarrësia dhe zhvillimi

Një universitet i suksesshëm duhet ta rrisë nivelin e njohurive të studentëve, por ka nevojë edhe për të shërbyer si një udhëheqës për zhvillimin e rëndësishëm për komunitetin. Sektori real privat dhe publik në mjedisin lokal dhe më gjerë duhet të fitojë nga aktiviteti i Universitetit, gjithashtu. Shkëmbimi i njohurive dhe i rrezikut me sektorin privat është logjika normale e universiteteve më të njohura në botë. Njohuritë e përbashkëta janë të nevojshme për të ulur shpenzimet, për të siguruar më shumë kursime dhe investime në të dy sektorët, publik dhe privat. Universiteti duhet të jetë pjesë e këtyre proceseve dhe të ndajë një pjesë të të ardhurave, gjithashtu. Fitimet nga aktivitetet sipërmarrëse të Universitetit duhet të bëhen një pjesë e rëndësishme e strukturës së të hyrave financiare të Universitetit.

Veprimtaria sipërmarrëse e Universitetit duhet të nënkuptojë forma të shumta. Pjesa më e madhe e punës që ne shohim vjen përmes Qendrës për zhvillimin e biznesit, e cila është pioniere në mënyrat se si Universiteti mund të bëjë lidhje biznesi me komunitetin e biznesit lokal, kombëtar dhe rajonal. Qendra ishte përfshirë si logjistike në programin e biznes analizës e ku Universiteti ishte nikoqir i 70 studentëve indianë në kampusin tonë.

Aktivitete të tjera të rëndësishme të kësaj organizate janë sesionet trajnuese. QZhb, e cila ka ofruar trajnime për profesionalizëm, zhvillimin e planeve të biznesit, përgatitjen e udhëheqësve dhe seanca të tjera që kanë të bëjnë me korporatat dhe menaxhimin dhe këto oferta i ka prezantuar tek kompanitë dhe OJQ-të vendore.

Qendra ka krijuar edhe një plan biznesi për një kompani lokale (INTERLIGHT), ka ofruar ueb dizajn për pesë kompani dhe ka bërë marrëveshje të marketingut me gjashtë kompanitë lokale për marketing promovues.

QZhb ka fituar së fundmi tenderin për organizimin e trajnimeve për Ministrinë e Ekonomisë dhe ky projekt pritet të fillojë në fund të nëntorit 2012.

8.0 Financimi

Universiteti vazhdon të jetë plotësisht i vetëfinancuar, i varur nga pagesa e shkollimit nga studentët, pra pjesa më e madhe të të ardhurave. Pavarësisht se fuqishëm kontribuon në buxhetin e Republikës së Maqedonisë (taksa paguhen për rrogat, pajisjet, etj) dhe natyrën publike të disa prej fakulteteve të tij, UEJL ende nuk ka marrë fonde nga buxheti shtetëror. Proporcioni i të ardhurave për vitin akademik/VF 2011/12 ishte si vijon: të ardhurat nga pagesat për shkollim 85,47%, të ardhurat komerciale 5.35%, të ardhura të tjera (interesi, investimi në tregun e kapitalit, etj) 2.61%, dhe projekte dhe donacione 6.57%.

Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare vazhdon të mbetet prioritet për strategjinë zhvillimore të Universitetit dhe diversifikimin e të hyrave mendohet të ulet proporcioni i varshmërisë ndërmjet burimeve të ndryshme të të hyrave. Diversifikimi i portofolit të të ardhurave vazhdoi me investimet në tregjet e kapitalit me anë të një fondi investimi.

Përmirësimi kryesor në menaxhimin financiar gjatë vitit akademik/fiskal 2011/12 ishte zhvillimi i vazhdueshëm i Enterprise Resource Planning (ERP), si zhvillim të sistemit ekzistues. Qëllimi është të kalojë sistemi ekzistues financiar në platformën ERP e cila do të zhvillojë menaxhimin e sistemit të informacionet të UEJL-së, krijimin e raportimit të vazhdueshëm, të përmirësojë nivelin e informatës kthyesë dhe të zhvillojë komunikimin në mes departamenteve dhe zyrave të ndryshme brenda Universitetit.

Këtë vit u bë shqyrtimi dhe përmirësimi i procedurave në mënyrë që të zbatohen politikat financiare dhe të kontribuojë në forcimin e kontrollit "ex-ante" dhe "ex-post". Ky përmirësim ka kontribuar që të mbetemi pikërisht në kuadër të buxhetit të planifikuar.

Fakultetet/qendrat dhe departamentet kanë marrë pjesë aktive në procesin e planifikimit afatmesëm të buxhetit. Për të lehtësuar këtë proces Universiteti ka organizuar trajnime për stafin përkatës për zbatimin e procedurave financiare për realizimin e buxhetit.

Të gjitha rregulloret dhe procedurat financiare janë zbatuar me saktësi gjatë realizimit të projekteve dhe për këtë arsye në mënyrë të konsiderueshme është përmirësuar menaxhimi i projekteve.

9.0 Shërbimet dhe mjedisi në kampus

9.1 Përkrahja e studentëve

Përkrahja e studentëve kryesisht realizohet nëpërmjet Shërbimit studentor dhe Zyrës për përkrahje financiare. Studentët për vitin akademik 2011/2012 janë përkrahur përmes programit për bursa të Universitetit, programit për bursa të donatorëve, programit *Work and Study* dhe programit për lehtësim financiar për studentin e dytë dhe të tretë nga e njëjta familje.

Programi i bursave përbëhet nga dy grupe: programi për bursa meritore të Universitetit, i bazuar në rezultatet e treguara në testimin preliminar të njohurive dhe programin për bursa, bazuar në nevojën financiare në bashkëpunim me Institutin shoqëri e hapur (Open Society -Soros) dhe Ambasadën e Mbretërisë së Holandës. Në nivel të Universitetit 322 bursa janë dhënë, gjegjësisht 150 bursa meritore dhe 172 bursa në bazë financiare, çfarë do të thotë se afro 11% nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt janë përkrahur me bursa që mbulojnë 80% të pagesës së shkollimit në programin relevant të shkollimit.

Nga pikëpamja financiare, rreth 4% e studentëve janë përkrahur përmes programit "*Work and Study*". Përmes këtij programi, studentët ishin të angazhuar në shërbimet e ndryshme të universitetit duke përfituar nga përvoja relevante dhe ata e kanë realizuar mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik 110 studentë janë të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL, është bërë zbritje në pagesën e shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Ky program mbështet 133 studentë, që është 5% e nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt.

Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të aksesit efektiv për studentët me nevoja të veçanta dhe mundësitë për bursa për këtë grup të studentëve.

9.2 Ngrehinat dhe mirëmbajtja

Kampusi i universitetit vazhdon të jetë një mjedis atraktiv dhe unik në Maqedoni dhe më gjerë.

Edhe këtë vit pastërtia, rendi dhe mjedisi jetësor në kampusin e Universitetit ka marrë nota të mira nga përdoruesit e këtyre shërbimeve – studentët dhe stafi. Kjo është arritur me angazhimin e të gjithë studentëve dhe të punësuarve në Universitet si dhe me përkushtimin e departamentit të mirëmbajtjes.

Përskaj kësaj, Universiteti ka intensifikuar përpjekjet për të përmirësuar performancën dhe efektivitetin e departamentit në lëmin e mirëmbajtjes dhe logjistikës në kampus. Për ta mundur këtë përmirësim është bërë ristrukturim vertikal në sistemin e menaxhimit të departamentit të mirëmbajtjes. Gjithashtu, me qëllim të ekonomizimit me resurse, departamenti e ka ndërruar strukturën organizative të deritanishme më shumë mekanike dhe ka zëvendësuar atë me një strukturë organike e cila si bazë ka proaktivitetin e njësive për mirëmbajtje.

Stafi i Departamentit për mirëmbajtje dhe logjistikë është përfshirë në mënyrë aktive në zbatimin e procedurave të bazuara në standardet ISO si dhe në procesin e zhvillimit për të përmirësuar cilësinë. Janë përpiluar tre standarde të shërbimeve mirëmbajtëse në sferën e sigurimit, mirëmbajtjes së brendshme dhe të jashtme si dhe mirëmbajtjes teknike.

Universiteti vazhdon të jetë një shembull në rajon dhe më gjerë në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të kursimit të energjisë, gjë që kontribuon për shëndetin e studentëve dhe të komunitetit më të gjerë. Në këtë kontekst si dhe në kontekstin zvogëlimit të harxhimeve, janë arritur rezultate të mira në aspektin e kursimit të energjisë, sidomos me sistemin e ngrohjes (duke ekonomizuar maksimalisht me nxehjen në ditët e punës) dhe zvogëlimit të konsumit të energjisë elektrike (janë anuluar harxhimet për energji reaktive ashtu që ajo tani është zero).

Sa i përket mbrojtjes së mjedisit, Universiteti sivjet ka vazhduar me implementimin e Planit klimatik (PVK), në domenin e futjes në përdorim të gazit si dhe sistemit fotovoltaik. Ky përmirësim ka për qëllim reduktimin e gjurmëve të karbonit në UEJL dhe implementimin e strategjive për reduktimin e emisioneve të gazit serrë një afat kohor racional.

Në kuadër të mirëmbajtjes së planifikuar, gjatë periudhës së verës janë lyer fasadat e jashtme të të gjitha ndërtesave të fazës së parë. Këtu vlen të theksohet se për shkak të vjetërsimit të ndërtesave kostot e mirëmbajtjes së këtyre objekteve vazhdojnë të rriten.

9.3 Qendra e UEJL-së Shkup

Viti akademik 2011/12 ishte viti i katër i funksionimit të Qendrës së UEJL-së Shkup (UEJL Shkup). Numrat e regjistrimeve tregojnë një interes të qëndrueshëm për programet studimore që ofrohen në Shkup. Edhe pse institucionet alternative në kryeqytet vazhduan të ekzistojnë në një numër të madh, interesi për të studiuar në programet e ofruara në UEJL Shkup ishte i lartë. Qendra UEJL ka vazhduar të operojë në dy lokacione: ndërtesa kryesore dhe shtojca me katër klasa të pajisura. Madhësia e vogël e objektit me hapësira të kufizuara për mbajtjen e orëve mësimore dhe pothuajse mos ekzistimi i asnjë hapësire për aktivitete të tjera jashtë klasës mbeti e meta më e mëdha e funksionimit. Vendndodhja dhe pajisjet e klasave dhe zyrave duket të jenë elementet e forta tërheqëse për institucionin. Numri i stafit administrativ i angazhuar me kohë të plotë mbetet katër: drejtori i Qendrës, zyrtari administrativ, këshilltari studentor dhe menaxheri i ngrehinave.

Nga 1 marsi 2012 u emërua drejtori i ri: Dr. Vladimir Radevski, profesor inordinar nga Fakulteti i SHTB.

Një përmirësim i madh në aspektin e shërbimeve për studentët ishte themelimi i degës së Bibliotekës UEJL-së Max Van Der Stoel në Shkup. Biblioteka ofron të njëjtat shërbime, si rezervimin dhe huazimin e librave njësoj si biblioteka qendrore në Tetovë, duke përfshirë transferimin e librave dhe kthimin në Kampusin e UEJL-së në Tetovë. Nuk ka kompjuterë në shërbim për studentët që është konstatuar si mundësi për përmirësim, por kapacitetet e kufizuara dhe lidhjet IT nuk lejojnë për momentin një gjë të tillë, pra kompjuterë për qasje individuale të studentëve.

Qendra është e pajisur me një pajisje moderne për video-konferenca nga brezi i fundit në HD rezolucion (Polycom 6000) dhe ndodhet në hapësirat e bibliotekës. Në disa raste kjo pajisje është përdorur për të lejuar si drejtorin e Qendrës së UEJL-së dhe stafin për të ndjekur/marrë pjesë në takimet on-line në kampusin në Tetovë. Në një rast gjatë një ngjarjeje të organizuar në UEJL Tetovë është ndjekur online nga

studentët në Qendrën e UEJL në Shkup. Video sinjali është transmetuar nëpërmjet TV ekranit të sheshtë në HD dhe të pajisjeve të shkëlqyera audio.

Një sistem i video-mbikëqyrjes u instalua në hapësirat e qendrës (hyrje, korridoret në çdo kat, laboratorë kompjuterikë) dhe u integrua në sistemin e përgjithshëm të video mbikëqyrjes në UEJL. Materialet, si online dhe offline ende nuk janë të qasshëm nga stafi i UEJL Shkup, por ka komunikim të vazhdueshëm në përcaktimin protokolleve dhe standardeve për shfrytëzimin e materialeve në UEJL Shkup.

Këshilltari studentor është vendosur në një zyrë të veçantë. Kjo ka përmirësuar shumë cilësinë e shërbimit të ofruar, pra tash më që të dy shërbimet (këshilltari studentor dhe menaxheri i ngrehinave) kanë hyrje të veçanta. Pajisjet e projektimit në klasa janë mirëmbajtur dhe servisuar rregullisht.

Të gjithë kompjuterët në dy laboratorët kompjuterikë u zëvendësuan me brezin e ri. Të dhënat në dispozicion nga 231 studentë, që është vetëm rreth 30% e numrit të përgjithshëm të studentëve në Qendër, tregojnë se në UEJL Shkup administrata ka notë mesatare të lartë për shërbimet që ofron. Disa pika të ulëta janë konstatuar për disa nga shërbimet bibliotekare të cilat ne mendojmë se do të përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme në raportin e vlerësimit të ardhshëm për shkak të ndryshimeve të fundit dhe përmirësimeve të shërbimeve bibliotekare në UEJL Shkup.

Problemet me hapësirën e kufizuar për të punuar jashtë nga klasat (konsultime, punë në grup ose ekip, punë individuale dhe të ngjashme) mbetet të jetë një çështje për qendrën, si dhe mungesa e hapësirës dhe objekteve ku studentët mund të qëndrojnë në Qendrën para ose pas ligjëratave të tyre.

9.4 Burimet njerëzore

Universiteti, konform planit të veprimit dhe rekomandimeve nga Bordi për vitin akademik 2011/2012, pas kompletimit, miratimit dhe vënies në përdorim të disa dokumenteve bazike nga viti paraprak akademik si Rregullorja për rangim dhe paga, Doracaku i rregulloreve dhe procedurave të tjera gjatë këtij viti akademik është fokusuar në implementimin e tyre dhe në iniciimin e procedurave plotësuese në përputhje me rregullativat ligjore të Ligjit të arsimit të lartë dhe Ligjit për marrëdhënie pune të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë vitit akademik 2011/2012 janë përmbyllur të gjitha rastet e angazhimit të stafit akademik ndërkombëtar duke përfshirë edhe dokumentacion e vlefshëm lidhur me statusin e tyre (marrëdhënie të rregullt pune).

Çështja e mundësive të kufizuara për angazhime të reja nga njëra anë dhe kërkesat e departamenteve për t'u furnizuar me resurse njerëzore nga ana tjetër ka imponuar edhe hartimin e një draft rregulloreje për sistematizimin e vendeve të punës ku rëndësi të veçantë u kushtohet nevojave të universitetit për staf akademik, gjendjes aktuale dhe avancimeve në thirrje konform dispozitave ligjore dhe rregulloreve përkatëse.

Procesi i vlerësimit të stafit ka ecur sipas procedurës për vlerësim dhe në afatet e parapara. Rezultatet nga ky proces që kanë të bëjnë me trajnimin dhe perfeksionimin e stafit janë në trajtim e sipër nga zyrat administrative dhe zyrat e dekanëve.

Në vitin akademik 2011/12 Universiteti ka bërë një përparim të dukshëm në avancimin e stafit sa u përket titujve shkencorë dhe mësimorë. Ky avancim ka kontribuar edhe në zvogëlimin e varshmërisë së Universitetit nga stafi akademik me orar të shkurtuar gjë që mund të shihet në tabelën e mëposhtme.

Në vazhdim tabela me të dhënat (kualifikimin) për stafin akademik gjatë tre viteve të fundit

Stafi akademik – me orar të plotë dhe të pjesshëm (Full/Part Time) (2010, 2011, 2012)

	2010		2011		2012	
Stafi akademik		Numri i anëtarëve të stafit		Numri i anëtarëve të stafit		Numri i anëtarëve të stafit
Doktorë shkencash		101		136		122
Magjistra		91		89		73
Të diplomuar		24		18		12
Gjithsej		216		243		207

Stafi administrativ ka vazhduar edhe këtë vit me konsolidimin e shërbimeve administrative duke kyçur në masë të konsiderueshme teknologjitë informative (TI) në shumë procese që zhvillohen në të gjitha departamentet administrative dhe

akademike. Kjo ka rritur dukshëm eficiencën dhe mbështetjen që administrata i jep stafit dhe departamenteve akademike. Në përmirësimin e funksionimit të administratës rol të madh ka luajtur edhe organizimi dhe realizimi i trajnimeve të në kuadër të universitetit.

Procesi i rekrutimit ka ecur në përputhje me procedurën për rekrutim dhe ka rezultuar me vlerësim pozitiv nga përgjegjësit për të gjitha punësimet e reja. Këtu duhet të cekim se rol me rëndësi në këtë proces ka luajtur sidomos angazhimi i stafit ndërkombëtar nëpër komisionet intervistuese.

Në vazhdim tabela me të dhënat (kualifikimin) për stafin administrativ gjatë tre viteve të fundit

Stafi administrative – me orar të plotë dhe të pjesshëm (Full/Part Time) (2010, 2011, 2012)

Stafi Administrativ	2010		2011		2012	
		Numri i anëtarëve të stafit		Numri i anëtarëve të stafit		Numri i anëtarëve të stafit
Doktorë shkencash		5		6		5
Magjistra		18		12		15
Të diplomuar		70		72		75
Të tjerë		37		32		34
Gjithsej		130		122		129

9.5 Sistemi i informacionit

Gjatë vitit të kaluar akademik Universiteti ka vazhduar përpjekjet drejt qëllimit për zbatimin e mjedisit elektronik i cili do të na mundësojë që të ndajmë informacionin e proceseve të Universitetit ndërmjet të gjithë aktorëve relevantë dhe njërive të Universitetit dhe sidomos të japim informacione të efektshme të menaxhimit të Universitetit për procesin e vendimmarrjes të bazuar në dëshmi.

Shtytësi kyç për realizimin e këtij qëllimi është *Enterprise Resource Planning* sistemi ERP, zbatimi i të cilit filloi vitin e kaluar akademik. Në këtë drejtim disa hapa të rëndësishëm janë kryer. Një modul për buxhetimin është përcaktuar dhe është

vendosur si pjesë e zgjidhjes kryesore për zyrën e financave. Një modul fillestar i burimeve njerëzore është ripërcaktuar dhe është vënë në funksion për të përmbushur kërkesat shumë të veçanta nga Departamenti i burimeve njerëzore që u mundëson atyre të ndjekin historinë e plotë për titujt akademikë për çdo staf akademik dhe të jetë në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë. Ndërlidhja e një moduli të zyrës së bursarit me modulën kryesor për buxhetimin si pjesë e sistemit ERP është realizuar, gjithashtu. Të gjitha këto hapa të nevojshme që moduli i raportimit, i cili luan rol të rëndësishëm për sjelljen e raporteve të ndryshme vazhdueshme për menaxhmentin e Universitetit, do të zbatohen.

Arritje të rëndësishme janë edhe përmirësimet e realizuara në sistemin UMS ashtu siç kërkohet nga Departamenti i shërbimeve studentore. Një sistem i ri për kontabilitetin për zyrën bursarit, u zhvillua kështu që mund të integrohen lehtësisht me sistemin e kontabilitetit, si pjesë e zgjidhjes ERP. Gjithashtu përmirësime në afatin kohor dhe modifikime janë bërë. Sistemi i E-Notimit është përmirësuar me instrumente të reja për të thjeshtuar dhe përshpejtuar procesin e notimit. Ky hap gjithashtu është integruar në platformën MySEEU.

Më shumë funksionalitete janë zhvilluar në portalin MySEEU për të akomoduar kërkesat e ndryshme nga përdoruesit e fundit. U zhvillua një modul në mënyrë që stafi mësimdhënës mund të regjistrojë praninë e tyre në klasë në pajisjet RFID të cilat janë instaluar tashmë në të gjitha klasat. Një funksionalitet tjetër u shtua në platformën MySEEU, ashtu siç është kërkuar nga studentët, pra bëhet fjalë për “*My Curriculum*” që u mundëson studentëve të kenë informacion të dorës së parë për kurrikulumin aktiv të tyre. Me qëllim që të jenë në gjendje të ndjekin çdo certifikatë të lëshuar nga Libri kryesor i studentëve.

Duke pasur parasysh se IT teknologjia luan rol kyç për realizimin e proceseve të shumta që kemi përmendur më lart, ne si Universitet kemi vazhduar të ruajmë pozitën tonë udhëheqëse në ndjekjen e standardeve më të fundit në këtë fushë. Kemi bërë migrimin e suksesshëm nga mjedisi fizik në mjedis virtual, i cili na mundëson të zbatojmë zgjidhje të fundit me disponibilitet të lartë. Ky hap ka minimizuar joproduktivitetin e shërbimeve tona dhe në të njëjtën kohë ka ngritur fleksibilitetin dhe efikasitetin e sistemit. Kjo arrihet duke analizuar praktikën më të mira për implementimin e resurset private dhe instalimin e zgjidhjeve të fundit për virtualizim. Gjithë kohës kemi pasur parasysh standardet më të fundit për vazhdimësinë e biznesit dhe rekomandimet nga dy raportet e auditimit të jashtëm për siguri.

Lidhur me sistemin telefonik, në fund kemi zëvendësuar sistemin e vjetër me zgjidhje VoIP dhe ky sistem i ri hap shumë mundësi të reja për komunikim modern, ndërsa në të njëjtën kohë ka rezultuar me shpenzime të konsiderueshme më të ulëta mujore për shërbimet e telekomunikacionit.

Këto përmirësime të realizuara nga Departamenti i TI kanë dëshmuar përkushtimin e Universitetit tonë që të vazhdojë të jetë në mesin e liderëve në implementimin e teknologjisë më të fundit nga fusha e TI me synim të vazhdueshëm për të siguruar mbështetjen e nevojshme për studentët dhe stafin drejt realizimit të misionit të Universitetit.

9.6 Shërbimet e bibliotekës

Biblioteka “Max van der Stoel Library” është vendi qendror për libra, revista, teza të magjistraturës dhe doktoratës, të mbledhura në Universitet. Shërbimet bibliotekare ofrojnë mbështetje për fakultetet për ofrimin librave që janë relevante për programet e studimit që ofrohen në Universitet. Stafi i bibliotekës vazhdimisht i monitoron premisat, si për të ndihmuar studentët ashtu dhe për të ruajtur koleksionet. Më e rëndësishmja është se biblioteka ka rivendosur instrumentin për kërkim online EBSKOhost, një zhvillim i rëndësishëm në përkrahje të hulumtimit në UEJL, nga stafi ose studentët. Biblioteka gjithashtu ka hapur degën e bibliotekës në UEJL-Shkup, çka mundëson përkrahje më të madhe për studentët në të dy lokacionet akademike. Stafi i bibliotekës shpreson të promovojë shërbimet për studentët duke bashkërenditur blerjen e librave sipas kërkesave të kurrikulave dhe për të zgjeruar aksesin dixhital të materialeve ndryshe nga hapësira e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

9.7 Unioni i studentëve

Unioni i studentëve ka ruajtur aktivitetet e veta tradicionale për këtë periudhë, përfaqësuesit kanë marrë pjesë në disa takime të Senatit të Universitetit, kanë organizuar ngjarje sociale të rastit për studentët dhe kanë planifikuar "Eurotrip"-in e famshëm. Unioni i studentëve erdhi me një statut të ri, duke bërë ndryshime të dukshme për strukturën e tyre ata nuk do të jenë Unioni i studentëve, por Parlamenti

studentor. Zgjedhjet për këtë organ janë duke u promovuar gjerësisht dhe zgjedhjet do të zhvillohen në fillim të nëntorit 2012.

9.8 Sporti dhe rekreacioni

Universiteti i Evropës Juglindore në domenin e sportit për vitin akademik 2011/12 ka vazhduar të realizojë të gjitha aktivitetet e planifikuara sportive, përfshirë: garat ndëruniversitare në futsall, basketboll dhe ping-pong. Në këtë periudhë janë organizuar edhe turnirët në futboll, basketboll, shah, biç-volej, tenis, ping-pong dhe atletikë brenda kampusit. Në fushën e skijimit vlen të përmendet se është organizuar Kampionati ndëruniversitar mbarëkombëtar me moton `100 vjetori i flamurit kombëtar`. Me datë 27 Prill 2012 organizuam, po ashtu, një ditë sportive me moton **Dita Olimpike** ku përveç lojërave kolektive, çiklizëm dhe atletikë, u organizuan edhe lojëra të ndryshme popullore, derisa një javë më vonë për ditën e **Evropës** organizuam turnir në futboll ku morën pjesë ekipet e studentëve dhe të stafit punues.

Në fund vlen të përmendet se këtë vit akademik është rritur dukshëm numri i femrave që janë marrë me aktivitete sportive. Në sallë përveç studentëve, termin të posaçëm në javë ka pasur edhe stafi punues i UEJL-së.

Duke pasur parasysh natyrën e aktiviteteve dhe kushteve lidhur me departamentin e sportit, në perspektivë mendojmë se do të duhet të avancojmë performancën përmes: rritjes së intensitetit të aktiviteteve sportive, caktimin e një objekti në kampus në të cilin do të mund të zhvillohen aktivitetet sportive edhe në sezonin dimëror, të sigurohet orar më fleksibël për aktivitete sportive duke u bazuar në interesimin dhe orarin e studentëve si dhe blerjen e pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

10 Konkluzionet

Universiteti i Evropës Juglindore fillon dekadën e dytë të ekzistencës, me zhvillime shumë pozitive për të festuar. Ne kemi fituar Urdhrin e Meritës vetëm pas dhjetë vjet ekzistence, jemi renditur universiteti i dytë në nivel të shtetit dhe kemi ndërtuar ndërtesën e parë efikase të energjisë në një kampus universitar në Maqedoni. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë ekzistojnë dhe me proceset e monitorimit të kujdesshëm. Kurrikulat tona vazhdojnë të zhvillohen dhe të evoluojnë, duke ruajtur programe të forta në të dyja nivelet deridiplomike dhe pasdiplomike. Anketat tregojnë se kënaqësia studentore në Universitetin është në rritje. Ne kemi krijuar dy institute të reja hulumtuese për të udhëhequr dhe organizuar përpjekjet tona hulumtuese. Aneksi ynë në Shkup vazhdon të tërheqë studentë dhe me kompjuterët e rinj dhe shërbimet e bibliotekës ofrohen shërbime të përmirësuara për studentët.

Megjithatë, këto zhvillime pozitive nuk na kanë lënë pa sfida. Disa nga rekomandimet për veprim në të ardhmen janë si në vijim: diplomimi në kohë dhe norma e kalueshmërisë së studentëve duhet të përmirësohet; regjistrimet e studentëve duhet të rriten; studentët duhet të jenë më afër të integruar në programet e sigurimit të cilësisë dhe programet studimore duhet të monitorohen për të siguruar që ata të vazhdojnë të jenë në përputhje me nevojat e të pritshme të tregut për të diplomuarit.

Me konstatimin e këtyre pikëve është e rëndësishme të vihet në dukje në përfundim, dinamizmi i vazhdueshëm i universitetit. Vazhdimisht i përmirësojmë ofertat tona akademike, thellimin e lidhjeve tona me universitetet e tjera dhe bizneset, organizimin e konferencave dhe më e rëndësishmja – prodhimin e studentëve që kanë mësuar dhe përfituar nga koha e tyre në institucion tonë.

Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit

- Provosti
- Sekretari i përgjithshëm
- Këshilltari ekzekutiv për cilësi
- Drejtori i Qendrës së UEJL –Shkup
- Drejtori i Shërbimit studentor
- Përfaqësuesit e pesë fakulteteve
- Drejtori i Qendrës së gjuhëve
- Drejtori i Qendrës eLearning
- Zyrtari për sigurimin e cilësisë- përkrahje teknike